



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2380 Regj
Nr.2427 Prot

Tiranë, më 13.09.2024

URDHËR
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓
Adresa: Tirane
Per dijeni: Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit, Bashkia Tirane
Adresa: Tirane
Per dijeni: “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” me Nipt J629042640
Adresa: Fshati Balez Poshte, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusarth (ne kryqezimin e rruges se fabrikes se cimentos rrugen e fshatit Balez Siper), Elbasan.



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdherit te Ekzekutimit “Vendim Nr.1151 Regj Them, date 14.06.2024 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 2380, Datë 19.08.2024 kërkesën e kreditorit Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit, Bashkia Tirane ndaj debitorit “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” me Nipt J629042640, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendim per Denim me Gjobe nr.5055 date 05.10.2023”, per te cilin ka dale Urdheri i Ekzekutimit “Vendim Nr.1151 Regj Them, date 14.06.2024 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane. Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.2199 Prot, Datë 19.08.2024, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit “Vendim Nr.1151 Regj Them, date 14.06.2024 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Me Shkresën Nr.2327 Prot, datë 03.09.2024 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi aktivet e pales debitore “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” me Nipt J629042640, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar. Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimit te llogarive bankare rezulton qe detyrimi, eshte ekzekutuar teresisht. Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.2327 Prot, datë 03.09.2024, mbi aktivet e pales debitore “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” me Nipt J629042640, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

“ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE”
PËRMBARUESI GJYQËSOR

ERIS SOTIRI

